VENDIM
Nr. 12, datë 11.1.2016

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 375, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të nënndarjes "i", të shkronjës "ç", të pikës 6, të vendimit nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen fjalët "... dhe e drejta për të aplikuar *on-line* për shërbimet e miratuara me marrëveshje mes Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama